REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 347, Datë 12.11.2026

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR KËRKESËN E SHOQËRISË "VITOL ALBANIA GAS AND POWER" SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 40, pika 2, gërma "d" të ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike*"; neneve 4, pika 1, gërma "e", 5, pika 1, gërma "e" dhe 10, pikat 1 dhe 3 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma "a" të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.11.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 3216/1 prot., datë 10.11.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës *"Mbi kërkesën e shoqërisë "VITOL ALBANIA GAS AND POWER" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike"*,

Konstatoi se:

- Shoqëria "VITOL ALBANIA GAS AND POWER" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 3216 prot., datë 30.10.2026, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit dhe ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të përcaktimeve të "*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike"*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se:

Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pika 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas gërmave (a, b dhe c), duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në Shtojcën 1.
- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas gërmave (a, b dhe c).
- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas gërmave (a dhe c).

- Në përputhje me nenin 9, pika 2.5 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar rezulton e nevojshme që shoqëria të paraqesë sqarime dhe dokumentacion plotësues lidhur me tagrat e përfaqësimit të saj në kuadër të paraqitjes së aplikimit dhe ndjekjes së procedurës së licencimit pranë ERE-s, në përputhje me mënyrën e përfaqësimit të përcaktuar në aktet e shoqërisë dhe të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB). Gjithashtu, nevojitet të sqarohen natyra juridike dhe vlefshmëria e dokumentit të paraqitur për mbështetjen financiare, si dhe kompetencat dhe tagrat e përfaqësimit të personave që e kanë nënshkruar këtë dokument, duke paraqitur dokumentacionin përkatës provues.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën administrative për licencimin e shoqërisë "VITOL ALBANIA GAS AND POWER" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Shoqëria "VITOL ALBANIA GAS AND POWER" sh.p.k. brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të këtij vendimi, të paraqesë sqarimet dhe dokumentacionin plotësues lidhur me:
   - tagrat e përfaqësimit të shoqërisë në kuadër të paraqitjes së aplikimit dhe ndjekjes së procedurës së licencimit pranë ERE-s;
   - natyrën juridike dhe vlefshmërinë e dokumentit të paraqitur për mbështetjen financiare, si dhe kompetencat dhe tagrat e përfaqësimit të personave që e kanë nënshkruar atë.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë "VITOL ALBANIA GAS AND POWER" sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI